

BIBLIOTEKA
SHTETIT

8SH-1
H·63

**Udhë
dhe
njerëz**

AGIM HILA

poezi

8SH-1
H 63

AGIM HILA

UDHË DHE NJERËZ

— poezi —



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

TREGIMI I VETERANIT

Dëgjoni djem, mbi këta gurë,
dikur aq keq na ndezi;
se ishim ne të varfër shumë;
sa s'kishim gjalm për mezi.

Se kishim ne aq halle shumë,
sa arna në poture,
po nuk i ndamë nga mezi kurre
naganta e kobure.

Se kishim shumë armiq. të vjetër
që na kërkonin pjesë,
që na u derdhë tërë jetën.
si ujqër-o, për besë!

Dhe nëpër ara e sinore,
sa herë që na nganë,
i lamë në dhë të ngulur ploret
e ngjeshëm jataganë.

Oh, ç'pyet se ç'pamë me këta sy
mbi këta të sertë male,
mbi shpinë tonë qđo qeveri
harbutshe hidhte valle.

Çdo muaj zbriste në nahije
agai, taksa vilte,
bukë e misërt e fëmijëve
na dilte e s'na dilte.

Pa donte hoxha gjithë kësметet,
i donte një më një
dhe dësmat edhe ziafetet
peshqeshet, ç'ke më të!

Pastaj prefekti ynë me pallë!
Një burrë e palo burrë.
Njëherë të nă qante hallë
se pamë, o djema, kurrë!

E kishte raste që me ta
na ndizej gjaku keq.
Qëlloheshim; që mos e nga,
qëlloheshim, përqëdës.

Ndaj mbetëm malesh tërë jetën
në gërxhe duke hipur,
na griu supet pushkë e vjetër
e rrobat djersë e kripur.

Sa herë i vuri këmbën tokës
këtu ushtri e huaj,
ne plumbat ua drejtuam kokës,
i shtrimë përdhe si buaj.

Megjithëse gjunjët shpesh na dilnin
gjakosur mbi poture,
po s'donim kurrë të na mungonin
fishekët në kobure.

Se ishim ne të varfër shumë,
njeri s'na kish në pjesë,
barutin si bukën e mbanim
se s'kishim-o, për besë!

**Se kur mbaronin dhe fishekët
qëllonim ne me gurë...
Dëgjoni, djem, këto që them
dhe mos harropi kurrë.**

P E S H K O P I A

Midis nëntë malesh ngrihet Peshkopia
e sytë e bukur buzë Drinit lan.
dikur këtu pusinë kish hasmëria
në vrima kullash të zeza-katran.

Dikur këtu kish vetëm dushk e ferra
e toka nxinte pa u errur mire,
të çante bagëtinë me ikopera
afrohej bisha nëpër errësirë;

dikur këtu kish vetëm dy mejhane
ku mblidhej hasmëria për të vrarë,
ku mblidheshin gjermanë e italianë
të bënин plane tok me bajraktarë;

dikur këtu dibrani për lirinë
ndërronte pendën e qeve me dy tyta
dhe e kalonte maleve rininë,
duke qëlluar si sqifter në prita...

Ndaj e ngre zërin dibrani — bubullimë
e s'ngopet dot me bukuritë e fushës;
— O rrofsh Parti, Enver o djali ynë,
ta puthtë mixha çarkun tënd të pushkës!

Këtu na kini, grusht në një llogore,
ushtarë më besnikë për këto ditë
të lidhur si vëllezër dorë për dore
i bëjmë me këdo ne llogaritë.

Se tërë jetën zemra na kërkoi
ta pinte djersën tonë kjo tokë, si vesë,
o tërë jetën dibrani ëndërroi
për këtë drejtësi, për këtë besë!

BALADE PËR KOMISARIN BIRÇE SINEMATI

Ka dalë djali i bjeshkës në rudinë
e ndjenjat shtrin në tela çiftelie,
e ngre në këmbë tërë malësinë
kjo këngë e re, e bukur trimërie.

E zë radhit kujtimet nëpër mendje
aq ngjarje e aq data tërë fshati...
Ku je, vëlla, që tok me ne u mende,
o komisari Birçe Sinemati!

Të duam të na vish e të na thuash
për Shqipërinë e re e të pandarë,
se djemtë tanë të ndjekin ku të duash,
o komisar, aq malli na ka marrë!

Sa herë na theri plumbi përmbi shpatull,
u ngrite ti mbi llohrat e tufanet,
rrëmbeve armën varur përmbi hatull
e brite: «Burra, poshtë tek istikamet!»

Si nuk të pa njëherë djalëria
të lëdhur a mërzitur nëpër shtigje.
Ç't'u bë e dashur kaq kjo malësia
dhe për një djerrinë e dy brigje.

Ku ty si flamur të mbuloi gjaku,
atje ku s'kishte ujë për të pirë,
atëherë dhembjen s'e nxinte konaku
dhe shpirti i malësorëve të mirë;

atje ku del djaloshi flokëdrudhë,
mbështetur çiftelinë te xhamadani,
e mblidhen njerëzia te kjo udhë
e të kujtojnë, o Birçe partizani!

Kjo kënga jote mori malësinë,
se malësiave varfëri shumë të deshi,
ndaj e dredh zënë ky djalë mbi rudinë;
— «O, ishte trimi prej Kurveleshi!...»

MONOLOGU I USHTARËVE TË HUAJ

Ç'na pikon ikjo shpellë
ujë mbi helmeta!...
Jemi futur thellë,
thërrmojmë galeta.

Mbrëmë kontrolluan
te Qafa e Koçit,
si i thonë këtej
dhe në vrimë të miut.

Ja, këtu hajduçe,
mbetëm në pelena.
Vinte Grykës së Kuqe
luftëtar Bolena.

Kanë dalë fshatçë
gra e burra plot,
bëhet këngë labçë
dhe pushkë në Kotë.

Varen Mesaplikut,
si trofe pa vlerë,
nën grykë të belxhikut,
tanët oficerë.

Në qafë u rri tmerri
si shtérngim tevliku.
C'kish një vrap si erë
ky Jaho Gjoliku?

Kur kujtonte djemtë,
sytë i nxirrnin çika.
Ja njojin përrenjtë
zënë në sa prita...

Gjer në buzë të shpellës
kokën s'ngremë dot,
ç'bëmë që na dëmove
kaq egër, o zot!

Rimë posht nën shpellë,
hamë në helmeta,
ëndërrojmë gjellë,
thërrmojmë galeta.

rimë posht
hamë
ëndërrojmë
thërrmojmë

rimë posht
hamë
ëndërrojmë
thërrmojmë

rimë posht
hamë
ëndërrojmë
thërrmojmë

A R M I Q T È

Natën, vonë, më bazën tonë të Vlorës,
detarët tanë nuk i zinte gjumi,
buçiste dallga rreptë mbi vaporët
e bubuzhinte era porsi plumbi.

Përgjonin djemtë me sytë mbi bankina,
nëpër bazën sillej tradhtia,
pranë motorëve e nëpër makina,
ziente mendimi tek anija.

Përgjonin djemtë tanë dhe mendonin,
nga flota jonë diçkush kërkonte pjesë,
gjithë bazën tonë të Vlorës e kërkonin
ta merrnin bazën tonë me të pabesë.

Po baza jonë kollaj s'tundej nga gjiri
me kërcënime rrufjanësh e me zhurmë...
Ç'u mbeti djemve tanë pa mbyllur syri
pas tradhtisë së poshtër, nëpër gjurmë.

Për këtë bazë ç'e bënë ata fora
me oficerë e marinare të huaj.
Në mes të natës dritë u bënte Vlora,
gjer tej në malet, që nxinim porsi buaj.

Në valë radiosha, sinjal jepte Partia
Hrushovi komunizmin kish tradhtuar!...
Qarkuan qiellin e kaltër vija - vija
avionët tanë ende që pa aguar.

Përshëndetën bazën tonë të Vlorës,
detarët tanë që nuk e mbyllën synë,
ata që tërë natën ndër vaporët
në shënjestër e vunë tradhtinë.

PRAPË NË ÇETË TË KEMI, XHA SELIM!


U nda nga gjiri ynë xha Selimi,
vullnetari i vjetër i transheve,
një mëngjes së bashku me agimin
e përcollëm përmes batareve.

E përcollëm me koçat mbi armë,
të gjithë tok, për në banesë të fundit.
E përcollëm me dhembje dhe i thamë:
prapë të kemi me çetën e katundit!

Tok me ne e armët dorë për dore
zëri yt nuک shuhet kurrë në çetë.
Zëri yt i rreptë ndër llogore
ngrihet si gjëmim me bataretë;

tok me këngën — zjarr në poligone,
që në gjak ta ndezi tërë jeta...
Dhe se ishe plak në mal e hone,
nuk u ndave kurrë, o shok, nga çeta;

nuk u ndave kurrë njëherë nga armët,
as në një stërvitje a marshim;
ndaj e ngritëm zërin e të thamë:
prapë në çetë të kemi, xha Selim!



BARTU PLAK

Vështrimin tret sa i ha syri,
në hone e në leqe,
ç'i sjell ndërmend ky brez kufiri,
një pritë me ca dyfeqe! . . .

Këtu dikur na vajti gjaku,
na vajti pa pushuar,
se na trazonte zemrat haku,
për tokën e pushtuar.

Mbi supe malet na i qëlluan:
e zemrat na i vranë,
po malet rreptë na kërkuan:
në luftë me Junanë.

Ç'u ndezén gjakrat kësaj gryke,
o dyzet ditë të tëra!

Në gjoks ua ngulëm maja thike,
të holla si gjilpëra!

Ç'u bënë djemtë e këtij mali,
me tirqe e me guna.

që plumbat bënин prej strallit,
në llohra e furtuna?

Ç'u bënë, t'ju themi se në zemra
ua kemi trimërinë,
se nuk ia lemë mbi këto shkrepia
Junanit ne kufinë!

Ç'e ndezim prush barinë e vjetër
kujtimet buzë kufirit...

Tek hedh vështrimin krahut tjeter
i lëshon çika syri.

E nis me vete fare lehtë,
nën shkrepje vetëtimash:
o ç'do të them, o djema, vetë,
një këngë të bukur trimash!...

MENDIME NË NJË NATE

Rri e vrash mendjen natën vonë
mbi tavolinë në dhomë të gjumit,
përmbi një vjershë të filluar
i hodha dhe vargjet e fundit.

Këtu në rreshta poezie
ulem e s'tundem me durim;
i shtoj një këngë trimërie
vêllimit që kam për botim.

E tek punoj më bren mendimi
ç'të shtoj më tepër e ç'të lë,
ç'figuracion nuk është i imi,
që ka shpëtuar nëpër të.

Punoj e marr qëndrim të prerë,
kur nënvizoj në vjershë armiqtë,
për ta, gjithë jetën, sa kam lerë
kam mbushur gjoksin plot: të liqtë!

E kam mësuar si nga ckërkat
qëllonim ne mbi ta pa bujë,
siç gjuajmë në verë nepërkat
të përvëluara pér ujë! . .

.....

O mëmëdhe, shpeshherë në vete
ndjej shpirtit thellë një stuhi,
t'i kam aq pranë të gjitha dertet
dhe sakrificat pa kufi!

Shpesh sytë kthej mbi obelisqe
e dhembshurinë s'e mbaj dot.
Ç'u bënë ata që ranë si bisqe,
që në Korab e Labinot?..

Ku janë t'u themi se i duam,
i kemi pranë zemrës-o,

as buzëqeshjen s'ua harruam,
le heroizmin jo që jo!

Sa herë në festa kujtimore
ia themi këngës pas të shtënave,
o, hapni rrugën, me fitore
nga lufta kthehen djemtë e nënave!

Të dhembshur rrinë njerëzia,
o veteranë ç'po mendoni?...
Aq pranë ndjenjave të mijë
ju kam gjithnjë te batalioni!

Dhe komandantë dhe komisarë
me shpirt të sertë e të mirë,
shembull sa herë ju kemi marrë
nëpër variante të vështirë.

Ndaj sa më jep sinjal borja,
vrapin e lë te pozicioni.
Se duhet shkruar poezia
dhe komanduar batalioni!

M E M O M E T U A

Bri horizontesh skuqnin vetëtimat,
shurdhonin bubullimat tej përenjtë.
Nëpër krahina qarkullonin trimat
e cirreshin ballistët si çakjenjtë.

Nga malet binte Memua, djalë vendi,
me trajstën plot me libra e fishekë.
Vështronte poshtë krahinën që e mendi
me burrerinë e njerëzve të thjeshtë.

Vështronte e nxitonte nëpër gjerdhe,
dylbitë ngrinte kuotë më kuotë,
përposh në fushë, si gjarpëri në çerdhe
kreu i «Ballit» në popull seç po thotë!

Kérkon ky bej të mbledhë fukaranë,
atë që thonjtë ia nguli në kurriz,
atë që e degdisi anë më anë
kérkon ta mbledhë si bagëtinë në mriz... .

O varet Memo — djali nga nometë,
çarapet plot me rrodhe, ujë në djersë,
përpjek vështrimin rreptë me rrufetë
e shkel me hap të sigurtë qersë më qersë.

Nxiton e s'i durohet të arrijë
(Në mend i rrinë debate e replika)
me Ali beun ballë për ballë të rrijë,
të derdhet midis tyre polemika.

Të ndjejë mbi shpatull dorën e krahinës,
të njerëzve që e ndoqën çap pas çapi...
Nxiton ai si një dëshirë e stinës
dheun e murrmë — rrufe ia shkelte vrapi.

KUR GABOI SHOKU YNË

Të thamë: Yt atë në grykë të Mesaplikut
në luftë u ther, u gri me ata horra
e ti kërkon t'i vëmë në vend të mikut
në zemrën tonë të pastër si dëbora.

Të thamë si vellezërit e mirë
me fjalë komunistësh, jo me derte:
s'përtypet bukë e hidhur me pahirë,
o djali i dëshmorit, xhaxha Mete!

Ta dish ti mirë se me një vajzë të bukur,
ata kërkojnë pjesë nga koha jonë,
në krahë komunistësh për t'u dukur,
në krahë të socializmit si ikonë.

Dhe ai «vjehrri» yt me aq «kulturë»,
dikur gjurmonte tanët mes Tiranës,
i mblidheshin përditë në prefekturë
me dhjetëra spionë nga anë e anës.

Po kur epoka jonë i përpiu,
u verdh i téri si një palo burrë
e doli nga bodrumet porsi miu
e u end rrugëve me njëqind flamurë...

Këtë të thamë e gjuha nuk na shkau,
kur të folëm irreptë në gji të masës:
më tepër së më pushkë ty të vrau
edhe për pak, o shok, armiku i klasës.

TE KY SHTEG LUFTE

Ejani, shokë, këto gjurmë të hershme shpien te
ky shteg,
ku ngriheshin gjokse-bregore,
ku sillej vdekja si nata,
ku derdhej zëri i luftës hon më hon e breg më
breg
në këngët barrikada.

Rrëmonin atëherë tokën gjyle edhe predha
e toka e djegur dhembjen hante me dhëmbë,
skuqte baruti i djegur bjeshkën, pisha e bregda,
oshëtinte e stundej bjeshka në këmbë.

Oshëtinte bjeshka e hidhte topa të rëndë, rrihte
pllaja,

nuš jepej para stuhisë,
përcillnin thirrjen e saj të rreptë honet maya më
maja:

— Mbi qentë e Halil Alisë! . .

C'thanë atëherë malësorët, kur ranë poshtë
llogore më llogore,
kur morën vajzën e rënë më vehte . . .
Mbeti partizania në kujtim të tyre

me bjeshkën dorë për dore,
kjo vajza Nimete, kjo trimja Nimete!

Se nra

Mbeti ajo me zemrën në buzëqeshje
me gjithë dëshirat që pati,
nëpër furtuna e përleshje,
Nimete Progonati.

Thanë atëherë malësorët e ëndërruan gjatë,
se si t'ja ngrinin kujtimin përmëndore . . .
E mbeti trimja labe në vatrat e tyre përnatë,
me leshra lëshuar llogore më llogore.

Se nra e kësaj vëllazëri, që i ka dhënë këtë përkohësi
njalle

MALOREN NGJIT...

Maloren ngjit e llogarit me mendje,
sivjet i mbushi plot të shtatëdhjetat,
i njeh për çdo pëllëmbë këto vende
dhe sa minuta mbajnë të përpjetat.

Jo, një minutë më prapa s'mund të vejë,
sekonda e thërret për në llogore,
sekonda e thërret për në betejë
me forcat e vetmbrojtjes popullore...

Baba, s'të pamë njëherë t'ia bëje «oh»,
kur që në shteg të thonë: «Alarm në çetë»!
Po ngrihesh ti me armë si lis i lartë
e pleqërinë e vë mbi bajonetë.

Të ndjekim ty e nëna flet me vehte,
si nuk të veshi fanellë nën xhaketë,
ti buzë transhesë ulesh e fshin djersën
e ndjen në shpirt guximin të fryjë rreptë.

Në pozicione ndjen erën e dheut
e malli të zurret poshtë arë më arë,
po sot ti je ushtar i mëmëdheut,
ushtar me thinja, shoku komisar!

MOTIV PARTIZAN

Në fshat qarkullonin tre vetë
me trakte e bomba në gji.
Thellonin fashistët transhetë
si ujqër frëngji më frëngji.

Lëvrintë në shesh si kuçedër
një tank i kalibrit të rëndë,
s'përmblahej më delja në vedër
e kau i urtë në parmandë.

Përtej në dyqan të agait
përhapej një qeshje me lot,
tregonte një farsë mullai
për një xhandar në Gërhot.

Për qejf i ndërronin italianët
bustinat me feste të kuqe...
«Komitët» kërkonin gjerdanët
të fshehura nëpër sënduqe.

Gjëmonte rinia: «O hej!
Vellezër për luftë gatiti!»
Një javë të shkuar këtej
kish dalë Mustafa Matohiti.

Kish dalë e me fukaranë
qe shtruar, kish pirë duhan:
Vellezër, në këmbë për vatanë,
nuk mbahet në shpinë ky dushman!...

Ne bukën e nxirrnim prej gurit
e djersa na hidhej si vesë,
po fjalën e kishim të burrit
e djemtë s'i hëngrëm në besë.

Po zemër u dhamë e në pushkë
të dashur ua bëmë këta gurë.
U thamë: në mbeçi pa bulkë,
pa tokë mos mbeçi ju kurrë!

MENDIMET MERRNIN DHENË

Mendimet merrnin dhenë e merrnin dhenë,
mendimet ku na shpinin atë natë...
Dy vëllezërit Gjoliku ku na mbenë,
dy djemtë e xha Jahos në një datë.

— ... Shokë, mbathni fort opingat mirë,
shokë, pregetiti për marshime,
me xha Jahon bashkë me t'u gdhirë
do t'i biem qenit m'u pas shpine!

Ç'do këtu që vjen e na vret trima,
ç'do këtu që vjen e na djeg xhane?!
Djema, pas meje si vetëtima,
t'i përbysim qentë përmatane!...

Mendimet merrnin dhenë e merrnin dhenë.
Mendimet si nuk reshtën atë natë?!. .
Dy vëllezërit Gjoliku ku na mbenë,
djemtë e komandantit në një datë.

Djemtë e komandantit me ne mbetën,
në marshime të gjata e shpinëmarrje.
Me mendimet tona merrnin dhenë,
duke sokëllitur për hakmarrje!

NË SHTËPINË E HEROIT

Shokë ushtarë, as ndjeni një trokitje
të fortë, të fortë në stendat e muzeut?...
Shikoni, mbi vështrime e vetëtitje
qëndron i thjeshtë si burrë dheu.

Gjëmojnë hapat e atij që kthehet nga atentati
nën dega e fleta,
gjëmojnë e vijojnë historinë,
para vështrimit të tij shtrihet e madhe, e madhe
jeta,
para tij shtrihen nga plumbat
ata që deshën të lidhmin
Shqipërinë.

Para tij ngrihet njeriu i klasës me grushtin e
rëndë,

njeriu i varför në fusha e male,
në qeli të burgut Heroi mbledh forcat e ngrihet në
këmbë,
këndon Internacionalen.

Merr rrugët kënga shteg më shteg e brinjë më
brinjë,
s'e mban dot qelia,
zien kënga bjeshkëve, lugjeve me fletë,
këndon Heroi e gjëmon historiа.

Dëgjonin njerëzit këngën në fusha e pyje të
shkreta,
moj këngë kaq e mirë, kush të ngriti?...
Mbi vjete shalonte koha këngën e rreptë nën
helmeta:
Nuk jepet jo, Nazmi Rushiti!

U mblodhën njerëzit atëherë kokë më kokë
pranë sofrës së besës,
sulmonte kënga e popullit lartësi më lartësi...
Mbani vesh si gjëmon kënga e shpërthen zemrat
si ndezës
dhe mos harroni shokë ushtarë të mi...

KUR LINDE TI...

Gjëmimi i luftrave, o djalë,
na dridhej nëpër rremba,
në istikam, plot një mëhallë,
ne rrnim si mbi gjëmba.

Mbi kokë retë kullonin — shpellë
e lufta na kërkonte,
jot ëmë veç me një fanellë
në fyt dhembjen shtrëngonte.

Nuk kishim neve asnjë kusht,
jorganë e ç'duhet tjetër,
ndaj të pështollëm sa një grusht
në një kapotë të vjetër.

Atje në luftë ta ndiem zënë,
në prita e gjëmime.

Jot ëmë kish dy ditë pa ngrënë,
pa ngrënë një thërrime...

Ç'të bënim, bir, në fshat s'na lanë
armiqtë si lugetër
dhe i qëlluam (se na nganë)
me maliherë të vjetër.

Ç'të bënim ne me një barë halle
nga kohë e zezë si murg
dhe morëm udhët nëpër male
me lot hakmarrje-çurg.

Kështu u derdhëm ne pa zë,
pas çdo furtune e llohe,
se hallet, bir, njëmijë e një,
namplaknin para kohë.

Ç'të bënim ne dhe maliherët
mbërthyem fort në fajet,
u ngritëm një mëngjes që herët
e shkretë i lammë konaqet...

Ndaj linde ti, o bir, värtetë
në llohë e kjamete
e sytë t'u poqën me rrufetë
ende pa ardhë në vete...

Kështu të rritëm ty atëherë,
në luftë për këto ditë
e shtatin tënd në rryma ere,
ta matëm me stuhitë.

Dhe të uruam që pagdhirë,
tek thyenim stuhinë:
të bëhesh, bir, njeri i mirë,
të bëhesh për Partinë!

NË HAN-SUBASH

Ka mbirë bar te han-Subashi,
hartallat ndarë në dy pjesë,
që nga bufeja usta Nasi
i frys ekspresit të kafesë.

Dikur kavaleri e kohës
vinin këtu kushdi se sa,
u derdhej sheshit palë e cohës
mbi kuaj sërbi — katana.

Rënkonin dhogat nën shpërngenjtë
si brinjë të dërmuari — kraik!
Diiku pas hani bilbilenjtë
përgjonin në një qorr-sokak.

Përgjonin bashkë natën vonë
mbi pashallarë e kishin synë,
atje te hani mbas një kodre
me erë bajge e trendelinë...

Që nga hajati pallte lopa,
tek milej ngutas në kabash,
gremisej psallti nëpër gropë:
diku luftohet usta-bash!

Nga qorrsokaku bilbilenjtë
mbulonin hatullat me tym.
E bija e hanit në shpergenjtë
pastronte qelqet në trishtim...

Por kohërat mbollën bar e cfakë
e mbi hartalla krimbi bren
e re atje rri veç një pllaçkë
me gërma ari në beden.

Tregon ajo për trimëritë
e një çete djaliërie,
që mbetën malit si komitë,
duke qëlluar mbi zaptie.

Se si i mbajtën këto hone
me pushkë e zemër disa vjetë,
si thyhen balle skuadronesh
në këto lugje plot me fletë...

Dhe usta Nasi nga bufeja
për Bilbiljenjtë na tregon...
Filxhanët mbush me ajkë kafeja,
sikur ekspresi krejt buron.

KUR RA POETI PARTIZAN

Ç'dëshirë la përgjysëm
te buzëqeshja e fundit,
o ç'brengë i theri zemrën
nga hallet e katundit...

... Ma vranë, ma vranë rininë
me predha sterrë të nxira,
rininë e bukurinë,
m'i prenë në mes dëshirat.

Përse m'i shkelën ëndrrat
të njoma, ende bisqe,
përse kërkuan sherre
që plumbi im t'i vriste?

Ç'kërkuan kësaj ane
si një ëndërr e keqe?...
Ata me mitrolozë,
ne krisëm me dyfegje.

Ata me top të rëndë,
ne zemrat vumë pritë...
Dhe mbeta unë në këngë,
në zemra atë ditë...

• • • •

Në krahë e shpinin shokët
mbi katër maljerë,
përzihej erë e luftës
me lulët në pranverë.

Në shpinë e mbanin shokët,
mendimet i përkundnin:
o' ç'këngë la në mes
te buzëqeshja e fundit?...

NË FUSHË TË KORABIT

Mbi këtë tokë jam ulur rrafsh me historimë,
shfletojmë e shfletojmë një më një,
kujtimet-helm s'i harron kjo krahinë
për karvanet e kurbetlinjve që s'u kthyen më.

C'na vijnë kaq pranë këngët e zemrave, këngët e
derteve,
moj fushë e Korabit e mjerë,
ku ndihej dhembja e hidhur si shkulmë e deteve
e s'shuhej kjo dhembje nga brezi në brez,
përherë e përherë.

C'u bënë ata që vanë e s'u kthyen më për jetë të
jetëve,
që treten në dhe të huaj...

Këputeshin dëshirat si lastarë të njoma mes fletëve,
këputeshin shpresat e nënave dhe të grave
e bëheshin duaj...

O ç'panë mbi kurriz të tyre këto majë e sheshel...
Tregojnë e tregojnë pleqtë e vjetër,
tregojnë vjetet për kohrat-rrebeshe,
tregojnë e umë i mbledh, i hedh në letër.

I mbledh, i ve në shpinë tok me pajime ushtari
e tregojmë për to me shokët korije më korije,
tregojmë e dëgjojmë këngën e re të lumtërisë në një
zë të ri këngëtar, zë
ç'i bie malësori lahutës për jetën e re, ç'i bie!

Nëno, po ti kështu nga dole,
duke kositur arë më arë?...
Një jetë të tërë ara vole,
po si ky vit njëherë s'ke parë.

Kjo fusha mbrëmë na bëri thirrje,
na nisi vjeshta në aksion,
po ti pa ne nuک mund të rrije
dhe pse tani je në pension.

Ti shpesh na mbledh e na flet neve
për mbretërit e qentë e tyre;
si dorë e hekurt e xhadeve
t'i nguli thonjtë në çaire.

Ti atë vit i corre faqet
se tokë-shkretën ta bënë gropë,
në vend të misrit gjer te praqet
të mbiu një taborr me topa...

Një jetë të tërë halle vole,
me brenga e mbolle këtë arë.
Jo asnjetëherë kështu nuk dole
e si ky vit njëherë s'ke parë.

Na ndoqe si bujkeshë e mirë
tok me rininë në aksion,
pa shuar yjet, që pagdhirë,
moj nënë e dashur në pension.

U S H T A R È T

... Sa herë jemi ndeshur me stuhitë
e kemi hapur shteg me bajoneta,
e kemi nxjerrë me krahë bateritë,
e kemi pritur shiun mbi helmeta;

pa jemi derdhur herët nëpër ara,
sa herë na ka bërë thirrje stina,
mbi plisa duart tona kemi vrarë
e kemi mbartur plehun me kofina...

Të tillë ushtarë jemi ne, vërtetë
të rreptë, atje ku na kërkon detyra,
punojmë arat e punojmë transhetë
e zgjidhim plot detyra të vështira.

Të tillë ushtarë na ka revolucioni,
ngjeshur supet me armë e vegla pune,
me sytë pishë përherë te pozicioni,
gjithnjë të gatshëm para çdo furtune.

N E F S H A T

Ku gëzojnë, ç'dasëm bëhet sonte?
Mbi shtëpinë time vallja lot,
unë duart shtrëngoj fort pas kapote,
kjo pranverë ma mbush gjoksin plot.

Si në dasmë fshati, si në festë,
po nis djem e vajza në aksion,
po nis vullnetarë për në bjeshkë,
ndaj hedh valle të bukurë e këndon.

Hej, ku jini moshatarë të mitë
me ballin e bukur si pranvera
dhe atje ku ruaj unë kufitë,
pranë zemrës ju kemi ngahera...

Jam ushtar nga brezi i kufirit,
që me leje vij sonte në fshat,
sup më sup me degët e ullirit,
bie monopat më monopat.

Malli më ka marrë për këtë tokë,
që ka ardhur si búka për t'u pjekur,
se jam bujk nga këmbët gjer në kokë,
që kam mall dhe për pak bukë të thekur.

Që kam mall të bie arë më arë
e gishtérinjtë me plisa t'i përziej,
tokën thellë ta çaj e të hedh farë
me duar fole pjepri të gërryej...

HIBE PALIKUQI

Nga rrugë e gjatë vjen ikjo vajzë:
ujin e gjurmëve ka pirë,
me gunë të leshtë e flokë të gjatë,
me bërrylë e gjunjë nga rruga mpirë.

Në këngët tona zbret ikjo vajzë,
si yll në krye të marshimit,
na vjen ajo nga rruga e gjatë
e flet për ditën e çlirimit.

Në dashuritë zbret ikjo vajzë,
nëpër kujtime djalërie,
fytyrë-butë e zemër bardhë,
ndër dhjetëra këngë dashurie...

Gjithnjë e shohim me agimet
nëpër biseda qdo mëngjes.
Lodhur e mpirë nga marshimet,
vatër më vatër yje ndez...

KËNDON NJË TOGË USHTARËSH

Këndon një togë ushtarësh
pranë armëve në transhe:
kapotat na kanë marrë,
thërrmija nga ky dhe...

Në dimër qoftë a verë,
a dita sa agon,
na gjeni ju përherë
me armë në pozicion.

Kjo toka jonë na jep
gjithë forcën e Anteut,
në sy të gjithë i kemi,
kuftjtë e mëmëdheut.

Dhe zemrat nëpër klone
i kemi vënë pritë,
me gjoks në pozicione
i thyejmë ne stuhitë.

NË S P I T A L

Ky mjek i mirë mbi kokë
më rri menduar shumë,
unë jam me ju, o shokë,
tek hidhni tok një lumë.

E nis thur në pushim
një vjershë bri llogores,
për mitralierin trim
dhe djersën e qafores...

Hej vargjet ç'më burojnë,
atje përmbi transhetë!
Një ditë do ta lexojmë
së bashku në gazetë...

Ku jini, shokë të mi,
nga ç'anë iu ngjitët malit,
nga ç'anë t'i vërtit sytë
këtej që nga spitali?...

SHPELLAT MBI KURORE

Shpellat mbi kurorë
rrinë si dy buaj,
poshtë në këmbë të tyre
hesht trualli i huaj.

Hapur qepengjitë,
sa një faqe muri,
këta gurë të rëndë
ç'dorë vallë i vuri?

Burgu në një anë
rri i zi si murg
në plasë të suvasë
rrjedh burimi-çurg.

Mbi qereçe-emra
shkruar dokudo,
kush e di sa zemra
mbetën nëpër to...

Plaku i moshuar
sytë mbi të nguli:
— Këtu kohë të shkruar,
rronte papa Zhuli.

Erdh' e la Pirenë
me mendim të prerë,
të ngrinte bedenë
kësaj toke djerrë.

Ku kish fshati vende,
tokë për të huaj?
Bukë mezi bënte,
sa për dy-tre muaj.

Dhe mbi armë flinte
fisi ynë i mirë,
nëpër luftra binte
me bukë e shëllirë.


Po nga gjithë luftrat
mbeti veç ky fshat,
tek të huajt bushtrat
lehën fillikat.

Pra të gjithsa erdhën
koha vet i shkuli,
njihet fshati ynë,
s'dihet papa Zhuli.

Dihet lufta jonë
që bëmë çdo herë...
Pa merre kutinë,
ta ndezim një herë.

Biem që të dy
në krahë mendimesh,
unë tymos cigare
mbi një bllok shënimesh.

Shpellat plot me borë
rrinë si dy buaj,
nën këmbë të tyre
hesht trualli i huaj.



PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Tregimi i veteranit	3
Peshkopia	7
Baladë për komisarin Birçe Sinemati	9
Monologu i ushtarëve të huaj	11
Armiqtë.	14
Prapë në çetë të kemi, xha Selim!	16
Bariu plak	18
Mendime në një natë	20
Memo Metua	23
Kur gaboi shoku ynë	25
Te ky shteg lufte	27
Maloren ngjit...	29
Motiv partizan	31
Mendimet merrnin dhenë	33
Në shtëpinë e heroit	35
Kur linde ti...	37
Në Han-Subash.	40
Kur ra poeti partizan	43
Në fushë të Korabit	45
Nëno, po ti kështu nga dole	47
Ushtarët	49
Në fshat	51
Hibe Palikuqi	53
Këndon një togë ushtarësh	55
Në spital	57
Shpellat mbi kurorë	59

Tirazhi 2 000 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-72

Shtyp. Kombinati Poligrafik

Shtypshkronja «Mihal Duri» — Tiranë, 1976